



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.33/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesuese, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Popović Danijela, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si i bazuar apeli Anr.33/2019. i Popović Danijela, paraqitur kundër KQZ për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës, **URDHËROHET** KQZ-ja të përfshijë votuesin Popović Danijela, në listat e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhje me datë: 19.09.2019 ka miratuar listën përfundimtare për votuesit jashtë Kosovës.

Me datë 20 shtator 2019 parashtruesi i apelit Popović Danijela, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të KQZ të datës: 19.09.2019 kur është miratuar lista përfundimtare e votuesve, me pretendimin se i njëjti edhe pse kishte aplikuar me datë: 04.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës nuk e ka gjetur emrin e tij në listë. I njëjti thekson se në të gjitha zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme ka pasur drejtë për të votuar, ndërsa në këtë rast është refuzuar paligjshëm.

Në përgjigjen e KQZ-se të datës 21.09.2019 theksohet se parashtruesi i apelit Popović Danijela, në momentin e aplikimit në KQZ nuk ka dërguar formular të aplikimit.

PZAP-i pas që shqyrtoj apelin vlerësoj se:

Apeli është i bazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i bazuar pasi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në momentin e aplikimit të njëjtin nuk e ka regjistruar si votues jashtë Kosovës, por Paneli gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se e njëjta ka kopje të dokumenteve valide dhe ka plotësuar formularin e aplikimit me datën 04.09.2019 me të cilat plotëson kushtet për t'u përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës. Prandaj paneli, ka konstatuar se apeli ka mbështetje ligjore në nenin 3.1, pika a), e Rregullës Zgjedhore

nr.03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “*Votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedhë fletëvotimin për zgjedhjet në bazë të procedurave që përcaktohen me këtë rregull të zgjedhjeve*”, pasi që në rastin konkret parashtruesi i apelit posedon dokumente valide të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës dhe njëherit i plotëson kriteret për të qenë pjesë e Listës së Votuesve.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.33/2019 më datën 22.09.2019.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*